

[Übersetzt in die Sprache Albanisch]

Kushtet e përdorimit:

Rregullat për kujdesin ditor të fëmijëve në qendrat për fëmijët dhe familjet në kopshtet Bremen

nga janari 2023

Informacion i rëndësishëm në fillim

Çfarë janë QpFF?

QpFF është emri shkurt për Qëndrat për Fëmijët dhe Familjet në kopshtet Bremen. QpFF janë vende për fëmijët dhe familjet e tyre. QpFF formon, edukon dhe kujdeset për fëmijët.

Çfarë është e rëndësishme për punën e QpFF?

- QpFF inkurajon çdo fëmijë në mënyrën më të mirë për fëmijën.
- QpFF punon së bashku me prindërit. Me prindër nënkuptohen të gjithë kujdestarët ligjorë. Këta mund të jenë për shembull, nëna dhe baballarë beqarë, prindër kujdestarë ose të afërm që jetojnë me fëmijët.
- QpFF punon së bashku me njerzit e Rrethit.

QpFF janë kontakte të rëndësishme për familjet. *Më shumë informacion mund të gjeni në broshurën „Koncepti për zhvillimin e qendrave për fëmijët dhe familjet.*

Për kë zbatohen kushtet e përdorimit?

Kushtet e përdorimit ofrojnë informacion në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e prindërve, fëmijëve dhe vizitorëve.

Marrëdhënia e kujdesit

Si të gjeni një vend për kujdesin e fëmijëve për fëmijën tuaj?

Ju duhet të paraqisni një aplikim për përkujdesjen. QpFF i përmbahet Aktit të Vendodhjes së Pritjes në Bremen.

Nëse një QpFF ka mundësi ta marrë fëmijën tuaj, ju do të merrni një konfirmim. **Ju duhet të konfirmoni pranimin me shkrim brenda 14 ditëve.** Përndryshe, një fëmijë tjetër do të marrë vendin në kujdesin për fëmijë.

Për sa kohë do të ketë fëmija juaj një vend në kujdesin për fëmijë?

Fëmijët pranohen gjithmonë për një vit kopshti. Viti i kopshtit fillon më 1 gusht dhe përfundon më 31 korrik. Nëse një fëmijë do të pranohet më vonë në kopsht, viti i kopshtit përfundon përsëri më 31 korrik.

Vendi i kujdesit për fëmijët është për një ofertë specifike, si për shembull një çerdhe, kopsht fëmijësh ose qendër përkujdesjeje pas shkollës. Fëmija juaj do të marri vendin për një numër të caktuar orësh në ditë.

Si mund ta zgjasni kujdesin për vitin e ardhshëm të kopshtit?

Ju duhet të paraqisni **çdo vit një aplikim të ri** për vitin e ardhshëm të kopshtit. Dhe ju duhet ta konfirmoni sërish brenda 14 ditëve me shkrim pranimin.

Nëse keni të drejtën edhe për një vit kujdesje, fëmija juaj do të ruaj vendin e tij në të njëjten QpFF. Kjo vlen për fëmijët në çerdhe dhe kopsht.

Kush është përgjegjës për mbikëqyrjen e fëmijës tuaj gjatë kujdesit?

Prindërit u japin punonjësve detyrën e mbikëqyrjes gjatë kohës së kujdesit në QpFF si dhe në ekskursionet. Detyra e mbikëqyrjes përshkruhet në nenin 1631, paragrafi 1 i kodit civil.

Ndërkohë që fëmija juaj është në përkujdesje, zbatohen rregullat e këtyre kushteve të përdorimit dhe rregulla të tjera nga KiTa Bremen.

Orari i hapjes, pushimet dhe shërbimet e urgjencës

Në cilat orare mund të vijë fëmija juaj në kujdesin për fëmijët?

QpFF janë të hapura nga e hëna në të premte nga ora 8 e mëngjesit deri në 4 pasdite.

Qendrat e kujdesit pas shkollës janë të hapura nga e hëna në të premte nga ora 13 deri në orën 16. QpFF do ta diskutojë këtë më parë me këshillin e prindërve.

Çdo QpFF vendos vetë nëse ofron turne të hershme apo të vona. QpFF pyet të gjithë prindërit për dëshirat e tyre. Pastaj QpFF shqyrton mundësitë dhe vendos se cilat shërbime janë në dispozicion. Shërbimet gjithashtu varen nga fakti nëse QpFF ka punonjës mjaftueshëm.

A mund të vijë fëmija juaj në QpFF gjatë pushimeve shkollore?

Gjatë pushimeve shkollore ka një shërbim të kufizuar. Oferta e shërbimit të pushimeve mund të ndryshojë nga oferta normale. Nëse dëshironi që fëmija juaj të vijë në shërbimet e pushimeve, duhet të paraqisni një aplikim në menaxhimin e QpFF në kohën e duhur përpara pushimeve.

Kur janë QpFF-të të mbyllura?

Gjate **pushimeve shkollore**, çdo QpFF mbyllet gjithsej 20 ditë pune në vit. 15 ditë nga këto janë në pushimet verore. QpFF bisedon më këshillin e prindërve paraprakisht për datat.

Ju do të informoheni çdo vit maksimumi ne mars se kur do të jetë QpFF e mbyllur. QpFF afer me njëra tjetrën i organizojnë kohët e pushimeve me njëra tjetrën. Nëse nuk ka mundësi tjetër, fëmija juaj mund të shkojë në një QpFF tjetër aty pranë. Katër ditë në vitin e kopshtit janë ditët e zhvillimit cilësor (**ditët QE**). Në këto ditë, punonjësit bëjnë trajnime të mëtejshme dhe zhvillimin e ekipit. Në ditët QE nuk do të ketë kujdesje. Menaxhmenti i QpFF cakton datat për ditët QE dhe i koordinon ato me këshillin e prindërve.

Në raste të veçanta, një QpFF mund të mbyllet ose do të ketë vetëm kujdesje të kufizuar. Kjo ndodh vetëm kur nuk ka alternativë tjetër. Për shembull, për shkak të një urdhri nga departamenti i shëndetësisë. Në një rast të tillë, fëmija juaj nuk mund të shkojë në një QpFF tjetër. Gjithashtu ju nuk do të merni para mbrapsh.

Mund të ndodhi gjithashtu që në QpFF të mos ketë punonjës mjaftueshëm. Për shembull, nëse shumë punonjës janë të sëmurë në të njëjtën kohë ose sepse nuk ka punonjës mjaftueshëm ose sepse punonjësit janë në grevë. Pastaj mund të ketë një gamë të kufizuar kujdesi dhe një shërbim urgjence. Shërbimi i urgjencës është për shembull:

- Jo të gjithë fëmijët mund të vijnë.
- Orari i hapjes është më i shkurtër.
- Një ose më shumë grupe do të mbyllën.

QpFF dëshiron të mbrojë fëmijët dhe të sigurojë një kujdes sa më të mirë për ta. Kjo është arsyeja pse mund të vijnë aq fëmijë sa punonjësit mund të kujdesen për ta. Qendra e kujdesit ditor në Bremen dhe ligji për kujdesin ditor deklarojnë se sa punonjës kërkohen.

Menaxhmenti i QpFF vendosin për shërbimin e urgjencës. Në varësi të numrit të punonjësve që mungojnë ka disa mundësi të ndryshme:

1. Do të anulohen aktivitetet edukative, p.sh. ekskursione ose përkujdesjet speciale për fëmijët individualë.
2. Oraret janë më të shkurtra. Ose turnet e hershëm ose i vonshëm nuk mund të zhvillohet.
3. QpFF kombinon grupe fëmijësh ose mbyll grupe individuale.

Prezenca, çregjistrimi dhe personat shoqërues

Çfarë duhet të bëni nëse fëmija juaj nuk mund të vijë në QpFF?

Fëmija juaj duhet të vijë rregullisht në QpFF në mënyrë që QpFF ta mbështesë sa më mirë fëmijën tuaj. Nëse fëmija juaj nuk mund të vijë, duhet të informoni menjëherë menaxhmentin e QpFF ose menaxhmentin e grupit. Nëse është e mundur, thoni edhe arsyen, për shembull: Fëmija juaj është i sëmurë.

Cilat jane oraret e qendrës së kujdesit pas shkollës për fëmijët e shkollës?

Për fëmijët e shkollës: QpFF mund të bjerë dakort me shkrim me ju për oraret specifike të qendrës së kujdesit pas shkollës.

A mund ta humbisni vendin e kujdesjes për fëmijën tuaj?

Ju mund të humbisni vendin e kujdesjes për fëmijën tuaj nëse ka një arsye të rëndësishme. Një arsye e rëndësishme është, për shembull: Nëse ju nuk i përmbaheni marrëveshjeve të rëndësishme. Në një rast të tillë më e rëndësishmja është më e mira për fëmijën tuaj.

QpFF mund t'ia japë vendin e kujdesit të fëmijës suaj një familjeje tjetër nëse fëmija juaj nuk ka qenë në QpFF për më shumë se dy javë dhe ju nuk keni njoftuar.

Përpara se QpFF t'ia japë vendin një familjeje tjetër, ajo do t'ju kontaktojë. Për këtë qëllim QpFF do t'ju dërgojë një letër të regjistruar. Me një postë të regjistruar, ju konfirmoni me firmën tuaj që e keni marrë letrën. Nëse ka një arsye të rëndësishme pse nuk keni mundur të na njoftoni, ju do të merrni vendin mrapsht.

A mund ta çregjistroni fëmijën tuaj nga QpFF?

Ju mund ta çregjistroni fëmijën tuaj në fund të muajit. Ju duhet të njoftoni QpFF-në të paktën 14 ditë përpara fundit të muajit. Nëse ç'regjistroni fëmijën tuaj në muajin e fundit para pushimeve verore, ju duhet të paguani edhe kontributet që do të mbeten. Nëse çregjistroni fëmijën tuaj sepse do të shpërnguleni, ju nuk duhet ti paguani kontributet që do të mbeten.

A mundet që një person tjetër të sjellë apo të marrë fëmijën tuaj?

Fëmija juaj duhet të jetë i sigurt rrugës për në QpFF dhe rrugës për në shtëpi.

Vendoseni me QpFF:

- Kur do e sillni fëmijën tuaj?
- Kur do e merrni fëmijën tuaj?
- Cilët persona të tjerë mund ta sjellin dhe marrin fëmijën tuaj?
- Cilët persona nuk lejohen ta marrin fëmijën tuaj?
- Për fëmijët e shkollës: Mund të shkoj fëmija juaj vetëm në shtëpi?

Çfarë është e rëndësishme për ekskursionet dhe udhëtimet?

QpFF ka nevojë për nënshkrimin tuaj në mënyrë që fëmija juaj të vijë me ne në ekskursione ose udhëtime.

Çfarë është e rëndësishme në motin ekstrem?

Në mot veçanërisht të keq, kushtojini vëmendje paralajmërimeve dhe informacioneve në Radio Bremen. Në rast stuhie apo ngrice, fëmija juaj mund të mos jetë në gjendje të vijë në QpFF.

Më shumë informacion mbi këtë temë, ju i gjeni në fletpalosjen „Paralajmërim në kushtet ekstreme të motit” të cilën mund ta merrni nga QpFF.

Ambientimi

Si funksionon procesi i ambientimit në QpFF?

Fëmijët duhet së pari të ambjentoohen me mjedisin e tyre të ri. QpFF dëshiron të kujdeset mirë për fëmijët e rinj. Kjo është arsyeja pse jo të gjithë fëmijët në një grup ambjentoohen në të njëjtën kohë. Ata e fillojnë njëri pas tjetrit vizitën në QpFF.

Menaxhmenti i QpFF përcakton rendin dhe e diskuton atë me prindërit.

Nëse e keni marë pranimin për datën 1 gusht, ju duhet të paguani kontributet prindërore që nga data 1 gusht. Kjo, edhe nëse fëmija juaj do të ambjentoohet më vonë.

Gjatë ambientimit fëmija juaj nuk duhet të ndihet i vetmuar. Prandaj, dikush që e njeh mirë fëmijën, si prindi apo dikush i besuar, duhet të vijë me të. Prindërit duhet të sigurohen që ata ose një person i besuar të vijë me ta.

Gjatë periudhës së ambientimit, stafi do të flasë shumë me ju dhe do të marrë vendimet më të mira për fëmijën tuaj.

Prindërit janë të përfshirë

Si mund të punojnë prindërit dhe QpFF sa më mirë së bashku?

Baza e punës sonë është bashkëpunimi i mirë me prindërit.

Ka rregullisht mbrëmje me prindërit. Të pakten një herë në vit, QpFF ju ofron një bashkëbisedim një për një dhe ju tregon se si po ecën zhvillimi i fëmijës suaj.

Prindërit zgjedhin një këshill të prindërve. Menaxhmenti i QpFF punon së bashku me këshillin e prindërve. Duke vepruar kështu, ajo i përmbahet udhëzimeve të Bremenit *për bashkëpunimin me komitetet e prindërve.*

Kujdesi shëndetësor

Çfarë informacioni ka nevojë QpFF për shëndetin e fëmijës suaj?

Të gjithë fëmijët në QpFF duhet të qëndrojnë të shëndetshëm. Shërbimi shëndetësor i fëmijëve dhe të rinjve këshillon QpFF-në për këtë. Ky shërbim është pjesë e Departamentit të Shëndetit të Bremenit.

Shkruani informacione të rëndësishme rreth shëndetit të fëmijës suaj për menaxhmentin e QpFF-së:

- A është fëmija juaj i sëmurë apo ka ndonjë problem shëndetësor?
- A ndikon sëmundja apo problemi në përkujdesje?
- A ka fëmija juaj alergji?
- A ka fëmija juaj intolerancë nga disa ushqime?

QpFF i shikon këto informacione dhe përshtat rregullat për to.

Fëmija juaj duhet të marrë ilaçe. Si funksionon kjo gjatë përkujdesjes?

Ndoshta fëmija juaj ka nevojë rregullisht për medikamente, për shëmbull sepse është i sëmurë kronik. Punonjësit nuk janë të detyruar t'u japin fëmijëve ilaçe. Ata mund ta refuzojnë këtë.

Kur punonjësit të jenë gati, gjithçka duhet të diskutohet në detaje. Për këtë gjë QpFF-ja ka nevojë për firmën tuaj. Ju gjithashtu duhet të dorëzoni një vërtetim nga mjeku ose mjekja juaj. Për këtë gjë mund të përdorni këtë formular: *Administrimi i medikamenteve UK-FHB në qendrat e kujdesit ditor.* Formulari duhet të përmbajë:

- Si quhet medikamenti?
- Sa shumë nga medikamenti duhet të marrë fëmija juaj?
- Kur dhe si duhet ta marrë fëmija juaj medikamentin?
- Si duhet të ruhet medikamenti?
- Çfarë efektesh anësore mund të ketë medikamenti?
- Çfarë mund të bëjë QpFF në rast urgjence?

- Si mundet QpFF të kontaktojë mjekun ose mjeken tuaj nëse ka pyetje (emri dhe numri i telefonit)?

Fëmija juaj ka një sëmundje ngjitëse. Çfarë duhet të bëni?

Fëmija juaj nuk lejohet të vij në QpFF me një sëmundje ngjitëse. Kjo vlen për sa kohë që fëmija juaj është ngjitës. Ndoshta menaxhmenti i QpFF-së do të donte një vërtetim nga mjeku ose departamenti i shëndetësisë përpara se fëmija juaj mund të kthehet në institucion.

Më shumë informacione do të gjeni në fletëpalosjen „Informacion mbi mbrojtjen e vaksinimit dhe mbrojtjen nga infeksionet në institucionet parashkollore“.

Si kujdeset QpFF për shëndetin e fëmijës suaj?

QpFF do t'ju njoftojë menjëherë nëse duket se fëmija është i sëmurë. Pastaj ju duhet ta merrni menjëherë fëmijën.

Nëse QpFF nuk ju arrin, menaxhmenti i QpFF-së mund ta çoj fëmijën tuaj te një mjek ose mjekje. Nëse është e mundur ajo e çon fëmijën te pediatri ose pediatria e tij.

Në rast të një aksidenti ose emergjence tjetër, menaxhmenti i QpFF-së mund të bëjë që fëmija juaj të trajtohet menjëherë nga një mjek ose mjekje.

Cilat ushqime mund të sjelli fëmija juaj në QpFF?

Ndoshta ju dëshironi t'i jepni fëmijës suaj ushqim nga shtëpia. Kështu ju duhet të respektoni rregullat e higjenes.

Ju ose fëmija juaj nuk ju lejohet t'i sillni këto ushqime me vete në QpFF:

- mish të papërpunuar (p.sh. mish i bluar, mish i grirë, ose tartar)
- sallam i papërpunuar që shtrohet në bukë
- qumësht i papërpunuar ose produkte të bëra nga qumështi i papërpunuar (p.sh. djathi nga qumështi i papërpunuar)
- mish i pjekur jo mire (p.sh. qofte)
- peshk i papërpunuar ose i tymosur (p.sh. salmon i tymosur ose sushi)
- ushqimet me vezë të papërpunuar (p.sh. ëmbëlsirat ose majoneza e bërë në shtëpi)
- akullore e shkrirë ose akullore që është e ringrirë
- sallatë me pulë
- ëmbëlsira me mbushje që nuk është e pjekur (p.sh. tortat me shukumë)

Më shumë informacione dhe këshilla mund të gjeni në informacionin për prindërit nga BIPS (Instituti Leibniz për kërkime parandaluese dhe epidemiologji). Informacionin për prindërit do ta merrni nga QpFF.

Vaksinat

Çfarë duhet të dini për vaksinimin kundër fruthit?

Të gjithë fëmijët kanë nevojë për një vaksinë kundër fruthit. Ju duhet të vërtetoni vaksinimin përpara se fëmija juaj të vijë në QpFF. Kjo është në *ligjin për mbrojtjen nga fruthi sipasi nenit 20 për mbrojtjen nga infeksionet*. Tregojini menaxhmentit të QpFF-së çertifikatën e vaksinimit ose një vërtetim nga një mjek ose një mjeke.

Të gjithë ata që janë në QpFF për më shumë se 3 ditë dhe më shumë se disa minuta duhet të kenë një vaksinë kundër fruthit. Kjo vlen edhe për prindërit, shoqëruesit gjatë periudhës së amjentimit dhe punonjësit. Prandaj duhet të vërtetoni vaksinimin kundër fruthit.

Këta persona nuk kanë nevojë për një vërtetim vaksinimi:

- Personat që janë intolerant nga vakcina.
- Personat që janë imun ndaj fruthit (për shembull sepse e kanë kaluar).

Këta persona duhet të paraqesin një vërtetim nga mjeku ose mjekja.

Nëse ju nuk keni një çertifikatë vaksinimi kundër fruthit, ju dhe fëmija juaj nuk lejoheni të vizitoni QpFF. Menaxhmenti i QpFF-së duhet t'ju raportojë më pas ju ose fëmijën tuaj në departamentin e shëndetësisë. Menaxhmenti i QpFF-së duhet t'i japë departamentit të shëndetësisë të dhënat tuaja, për shembull emrin, adresën dhe numrin e telefonit.

Çfarë duhet të dini për këshilat e vaksinimit?

Ju duhet t'i jepni QpFF-së një dëshmi se jeni këshilluar me mjekun për vaksinimin e fëmijës suaj. Në të kundërt fëmija juaj nuk do të lejohet në QpFF. Si dëshmi është e vlefshme:

- librezja e verdhë e kontrollit të fëmijës ose
- çertifikata e vaksinimit ose
- një vërtetim nga një mjek ose një mjeke që jeni këshilluar për vaksinimin

Nëse nuk mund të tregoni një dëshmi, menaxhmenti i QpFF-së duhet t'ju raportojë në departamentin e shëndetësisë. Menaxhmenti i QpFF-së duhet t'i japë departamentit të shëndetësisë të dhënat tuaja, për shembull emrin, adresën, ditëlindjen dhe numrin e telefonit të fëmijës suaj. Kjo është në ligj.

QpFF do të informojë departamentin e shëndetësisë nëse nuk tregoni dëshmi për këtë gjë më së voni katër javë pas vizitës së parë.

Siguracionet

A është fëmija juaj i siguruar në rast aksidenti?

Fëmija juaj është i siguruar nga aksidentet gjate përkujdesjes. Është një siguracion ligjor për aksidentet. Rregullat për sigurimin ligjor të aksidenteve janë përcaktuar në Librin VII të Kodit Civil.

Kur është i siguruar fëmija juaj në rast aksidenti?

- në rrugën direkt nga shtëpia për në QpFF.
- në rrugën direkt nga QpFF për në shtëpi.
- gjatë orarit të përkujdesjes.
- gjatë të gjithave aktiviteteve të QpFF, në ambjentet e QpFF ose në ekskursione.

Çfarë duhet të bëni nëse fëmija juaj pëson një aksident rrugës nga shtëpia për në QpFF?

Njoftoni menjëherë QpFF-në. Menaxhmenti i QpFF-së më pas raporton aksidentin tek kompania e sigurimit të aksidenteve.

A janë të siguruara rrobat dhe gjërat e tjera?

QpFF nuk paguan asgjë:

- nëse fëmija juaj humbet rrobat ose gjërat e tjera.
- nëse fëmija juaj ngatërron rrobat ose sendet e tjera me ato të fëmijëve të tjerë.
- nëse rrobat ose gjërat e tjera prishen.

Kontributi i prindërve

Çfarë është kontributi i prindërve?

Në ligjin e Brmenit për promovimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe neni 19 paragrafi 1 është: Prindërit paguajnë një kontribut prindëror nëse fëmija i tyre shkon në QpFF. Kontributi i prindërve është një kontribut vjetor me dymbëdhjetë këste. Kjo do të thotë: Ju paguani kontributin prindëror çdo muaj. Ju paguani kontributin e parë prindëror në gusht. Kontributin e fundit prindëror për vitin e kopshtit e paguani në korrikun e vitit pasardhës. Ju gjithashtu duhet të paguani kontributin prindëror edhe nëse fëmija juaj nuk e përdor kujdesin ditor gjatë pushimeve.

Kujt ia paguani kontributin prindëror?

Performa Nord llogarit kontributin tuaj prindëror dhe ju e paguani atë drejtpërdrejtë te Performa Nord. Performa Nord është caktuar nga rrethi Bremen.

Sa është kontributi i prindërve?

Kontributi i prindërve mund të jetë i ndryshëm për prindërit. Këto ligje përcaktojnë se sa do të jetë kontributi:

- *neni 19 paragrafët 1 deri në 4 dhe neni 20 në ligjin e Bremenit për mbështetjen e fëmijëve në qendrat ditore dhe kujdesin ditor dhe*
- *neni 1 paragrafi 3 i rregullores së kontributeve për kopshet*

Privatësia

Çfarë bën KiTa Bremen me të dhënat tuaja?

QpFF ruan të dhënat tuaja dhe të fëmijës suaj. QpFF i ruan të dhënat vetëm nëse e lejon ligji.

QpFF ruan disa të dhëna sepse të dhënat janë të rëndësishme për kujdesin e fëmijës suaj. QpFF ruan disa të dhëna sepse është një detyrim ligjor. Për disa të dhëna QpFF do t'ju pyesë paraprakisht nëse mund të ruhen.

Mund të mësoni më shumë rreth mbrojtjes së të dhënave në:

www.kita.bremen.de/datenschutz.

A janë fotografitë, filmimet ose regjistrimet zanore të lejuara?

Fotografitë, filmimet ose regjistrimet zanore të fëmijës suaj në QpFF mund të bëhen ose publikohen vetëm me lejen tuaj.

Prindërit gjithashtu kanë nevojë për leje nëse duan të bëjnë fotografi, filmime ose regjistrime zanore të fëmijëve të tjerë në QpFF.

Ngjarje të tjera në QpFF

A mund ta përdorin personat e tjerë QpFF-në?

QpFF janë vende për fëmijë dhe familje. Kjo është arsyeja pse të tjerët mund të përdorin gjithashtu QpFF-në dhe zonën e jashtme. Edhe institucione të tjera mund të përdorin QpFF-në gjithashtu. Për shembull

- institucionet që mbështesin fëmijët, të rinjtë dhe familjet.
- institucionet që mbështesin kulturën.
- institucionet që mbështesin sportin.

Referenca Kushtet e përdorimit nga KiTa Bremen në gjuhë të thjeshtë
Data Janari 2023
Faqja 11 nga 11

Rregullat dhe kostot përcaktohen nga KiTa Bremen. Pë këtë ka marrëveshje përdorimi dhe marrëveshje qeraje.

Megjithatë, kuzhina dhe gjithçka që ndodhet në të nuk lejohet të përdoret. QpFF sigurohet që përkujdesja të zhvillohet normalisht. Punonjësit nuk duhet të kenë punë pë shkak të përdorimeve shtesë.

Vlefshmëria

Këto rregulla do të zbatohen menjëherë

KiTa Bremen
Qendrat pë fëmijët
dhe familjet
në Bremen

Adresa postare
Auf der Muggenburg 5
28217 Bremen

Telefon
0421-361 5700
Telefax
0421-361 59771
E-Mail
office@kita.bremen.de
Internet
www.kita.bremen.de

[Übersetzt in die Sprache Albanisch]